



Nr. 7608/3 Prot



Nr.....Prot

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Lidhur sot më datë 02/11 /2011, në Tiranë ndërmjet palëve si më poshtë vijon:

BASHKISË SË TIRANËS, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë; përfaqësuar nga Kryetari, Z.Lulzim Basha;

dhe

UNIVERSITETIN E SPORTEVE TE TIRANES me adresë: “Rruga “Muhamet Gjollesha”, Tiranë; përfaqësuar nga Rektori, Z.Vejsel Rizvanolli;

Duke patur parasysh se:

Me synimin e përbashkët për realizimin e mbështetjes së studentëve si në vende të tjera të Europës me qëllim përfitimin e mallrave dhe shërbimeve nga shërbimet publike dhe private me çmim të reduktuar apo falas;

Me qëllimin për të kontribuar në mënyrë konstruktive dhe thelbësore në procesin e zbatimit të legjislacionit respektiv të dy institucioneve për arritjen e objektivave të përbashkëta duke ruajtur identitetin e tyre të ndryshëm, qëllimet dhe objektivat e tyre;

Me objektiva:

- Përmirësimin e jetës ekonomike të studentëve
- Uljen e kostove të jetës dhe të formimit akademik
- Rritjen e aksesit të studentëve në një kategori shërbimesh me qëllim rritjes e cilësisë së jetës
- Krijimin e statusit të studentit

Me angazhimin për të bashkëpunuar me njeri-tjetrin mbi bazën e parimit të reciprocitetit;

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligji nr.8652, datë 31.07.2000: “për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr.9741, datë 21.5.2007, për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar,

Kanë arritur mirëkuptimin si më poshtë:

Neni 1 **Objekti i Marrëveshjes**

1.1 Kjo marrëveshje ka për objekt bashkëpunimin e Bashkisë Tiranë me Universitetin e Sporteve të Tiranës me qëllim pajisjen e studentëve të këtij Universiteti me Kartën Bashkiake të Studentit.

Neni 2 **Angazhimet e paleve dhe format e bashkëpunimit**

- 2.1 Palët angazhohen dhe do të bashkëpunojnë me njëra tjetrën nëpërmjet:
- 2.1.1. Bashkërendimit në pajisjen e studentëve të këtij Universiteti me Kartën Bashkiake të Studentit sipas një axhende të përbashkët ku palët do të vënë në dispozicion si më poshtë:
 - 2.1.2. Pjesëmarrjes së përbashkët në grupet e punës për të koordinuar procesin e shpërndarjes së kartave bashkiake të studentit për të gjithë studentët e këtij Universiteti;
 - 2.1.3. Bashkërendimit në shkëmbimin e informacionit reciprok në monitorimin e këtij procesi
 - 2.1.4. Programimit të takimeve periodike për shkëmbimin e informacionit mbi aktivitetet e realizuara dhe bashkërendimin e atyre aktiviteteve që vlerësohen të nevojshme për t’u ndërmarrë në të ardhmen, të cilat do të jenë rrjedhojë e situatave të ndeshura në praktikë;
 - 2.1.5. Kryerjes së analizave dhe studimeve të përbashkëta me qëllim përmirësimin e procesit.
- 2.2 Palët angazhohen dhe do të bashkëpunojnë me njëra tjetrën duke realizuar këto detyrime reciproke:
- 2.2.1. Bashkia Tiranë do të përgatisë një platformë online e cila do ti vihet në dispozicion Universitetit të Sporteve të Tiranës me qëllim që të regjistrojë studentët me qëllim pajisjen me Kartën Bashkiake të Studentit
 - 2.2.2.. Bashkia do të sigurojë kushtet e nevojshme të prodhimit dhe shpërndarjes së Kartës Bashkiake të Studentit pranë IAL pa kompensim nga IAL
 - 2.2.3. Bashkia do të ofrojë për Universitetin e Sporteve të Tiranës kartat e nevojshme të cilat IAL do ti shpërndajë konform kriterëve dhe procedurave të këtij Universiteti.
 - 2.2.4. Universiteti i Sporteve i Tiranës do të sigurojë kushtet e nevojshme teknike për regjistrim të studentëve pranë Sekretarive Mësimore duke garantuar një proces të rregullt regjistrimi.
 - 2.2.5.. Bashkia Tiranë do ti ofrojë IAL Kartën Bashkiake të Studentit, e cila do të ketë këtë pamje të përbërë nga dy pjesë:

- a. Pjesa e parë e kartës, duhet të tregojë:
- 1) Emrin dhe mbiemrin
 - 2) Numri personal i Kartës së Identitetit.
 - 3) Fotografi të studentit, e cila duhet të jetë jo më e hershme se 12 muaj, me rozolucion të lexueshëm qartësisht fotografik dixhital;
 - 4) Afatin e përdorimit 1 Nentor - 12 Tetor 2012
 - 5) Kodin e KS: **04AAA0001** i përbërë nga sipas kësaj radhe:
 - Nr identifikues i Universitetit (numerik 2 shifror) radha do të përcaktohet nga Bashkia Tiranë,
 - Nr. Identifikues i Fakultetit (alfabetik: 1 gërmë) radha e të cilave do të përcaktohet nga IAL përkatës,
 - Nr. identifikues i Degës i Studimit (alfabetik: 1 gërmë) radha e të cilave do të përcaktohet nga IAL përkatës,
 - Nr. identifikues i Vitit të studimit (alfabetik: 1 germe: **A** per vitin e pare, **B** per vitin e dyte, **C** per vitin e trete, **D** per vitin e 4 dhe **E** per vitin e 5)
 - Nr Identifikues i Studentit (numerik 4 shifror) radha e të cilave do të përcaktohet nga IAL përkatës.
- Përcaktimi i kritereve për përgatitjen e Kodit të Kartës së Studentit përfshihet në përcaktimet e Administrimit të Bazës së të Dhënave të KS.
- 7) Emri i Universitetit dhe emri i Fakultetit
 - 8) Datëlindjen e Studentit
- b. Pjesa e dytë e kartës së studentit, duhet të tregojë:
- 1) Logon e Bashkise Tirane (përcakton Bashkia Tiranë)
 - 2) Logon e Universitetit (përcakton IAL)
 - 3) Barkodi me Kodin e KS (pika 6) (përcakton IAL)
 - 4) Logot e subjekteve mbështetëse

2.3. Palët do të përdorin një Rregullore të Përbashkët të Regjistrimit, Prodhimit dhe Shpërndarjes së Kartës Bashkiake të Studentit.

Neni 3 Komunikimi i Palëve

- 3.1 Palët komunikojnë në mënyrë të vazhdueshme ndërmjet tyre dhe shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore.
- 3.2 Palët do të caktojnë një person kontakti që do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret të Marrëveshjes së Bashkëpunimit.
- 3.3 Personat e kontaktit nga të dyja palët do të jenë të disponueshëm në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin e veprimeve me palën tjetër.
- 3.4 Me anë të përfaqësuesve të dyja Palët do të përcaktojnë radhën e mbledhjeve të grupeve të punës, kohëzgjatjen dhe periodicitetin e këtyre mbledhjeve.

Neni 4 Dispozita Përfundimtare

- 4.1 Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi lidhet pa afat të caktuar.

- 4.2 Çdo palë mund të kërkojë zgjidhjen e marrëveshjes, duke njoftuar palën tjetër 60 ditë para fillimit të vitit akademik mësimor në sistemin e arsimit të lartë.
- 4.3 Marrëveshja mund të ndryshohet, të amendohet ose të revokohet në çdo kohë, bazuar në pëlqimin e ndërsjelltë të Palëve të paraqitur me shkrim sipas pikës 4.1. të këtij Neni.
- 4.4 Në rast mosmarrëveshje të dyja Palët i zgjidhin ato nëpërmjet negocimit dhe mirëkuptimit.
- 4.5 Kjo marrëveshje bashkëpunimi hartohet në 4 (katër) kopje origjinale, dy për secilën palë.
- 4.6 Ky Memorandum Bashkëpunimi do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga Palët.

Nënshkruar në Tiranë, më ____/____/2011.

**PËR UNIVERSITETIN E
SPORTEVE TË TIRANËS**



**Z. VEJSEL RIZVANOLLI
REKTOR**

PËR BASHKINË TIRANË



**Z. LULZIM BASHA
KRYETAR**

